

MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME  
INSPEKTORATI POLICOR I KOSOVËS  
DEPARTAMENTI I INSPEKTIMEVE

---

**RAPORT**  
**I INSPEKTIMIT MBI VLERËSIMIN E RESPEKTIMIT TË**  
**LIGJSHMËRISË GJATË TRAJTIMIT TË KUNDËRSHTIMEVE TË**  
**PALËVE NDAJ SANKSIONEVE KUNDËVAJTËSE**

Nr. 2/2019

Prishtinë, 23 shtator 2019

## Informata të përgjithshme

---

<b>Titulli</b>	Raport i inspektimit mbi vlerësimin e respektimit të ligjshmërisë gjatë trajtimit të kundërshtimeve të palëve ndaj sanksioneve kundërvajtëse
<b>Data e përgatitjes</b>	23 shtator 2019
<b>Përgatitur nga</b>	Bekim Pira, Udhëheqës i Departamentit të Inspektimit
<b>Miratuar nga</b>	Miradije Kelmendi, Kryeshf Ekzekutiv i Inspektorati Policor i Kosovës
<b>Data e miratimit</b>	23 shtator 2019



### 1. Përmbledhja ekzekutive

- 1.1. Informacion i përgjithshëm mbi rezultatet e inspektimit.....(4-4)

### 2. Hyrje

- 2.1. Arsyet e inicimit të inspektimit.....(5-5)  
2.2. Qëllimi i inspektimit.....(5-5)  
2.3. Objekti dhe subjekti i inspektimit.....(5-5)  
2.4. Objektivat e inspektimit.....(5-5)  
2.5. Rëndësia e inspektimit.....(6-6)  
2.6. Metodologjia e inspektimit.....(6-6)  
2.7. Periudha e realizimit dhe mbulimit të inspektimit.....(6-6)  
2.8. Drejtimit e inspektimit.....(6-6)  
2.9. Kriteret e vlerësimit.....(6-6)  
2.10. Pengesat dhe kufizimet në arritjen e objektivave.....(6-6)

### 3. Përshkrimi i objektit, gjetjet dhe rekomandimet

- 3.1 Ligjshmëria në trajtimin e kundërshtimeve të palëve ndaj sanksioneve kundërvajtëse.....(7-11)  
3.2 Dosjet dhe evidencat.....(12-13)

### 4. Plani për përmbushjen e rekomandimeve

- 4.1 Plani i veprimit për realizimin e rekomandimeve.....(14-14)

Shtojca

## **1. Përmbledhja ekzekutive**

---

### **1.1. Informacion i përgjithshëm mbi rezultatet e inspektimit**

1.1.1. Në Policinë e Kosovës është i themeluar Organi kundërvajtës që trajton kundërshtimet ndaj sanksioneve kundërvajtëse, gjegjësisht kundërshtimet (kundërvajtjet) që bien në domenin e këtij Organi. Kompetenca për trajtimin e kundërshtimeve përcaktohet me Ligjin për Kundërvajtje, të vërtetuar edhe me Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese mbi kushtetutshmërinë e disa neneve të këtij Ligji, në mesin e të cilëve edhe të nenit mbi kompetencat e Organit kundërvajtës. Ndërsa, sistemimi i këtij Organi (Komisionit për Vendosje) në kuadër të shtyllës ku operojnë edhe njësitë e trafikut rrugor, si organe të shkallës së parë (të shqiptimit të kundërvajtjeve), është e nevojshme të rishikohet. Me gjithë faktin që Komisioni ka një bazë të gjërë ligjesh dhe aktesh nënligjore, në të cilat bazon punën e tij, është i nevojshëm rishikimi i akteve që rregullojnë kompetencat dhe fushëveprimtarinë e këtij Organi, për të qartësuar disa aspekte procedurale që janë identifikuar gjatë inspektimit. Vlerësohet se Komisioni ka një ngarkesë evidente me raste dhe nevojitet ngritja e kapaciteteve funksionale. Komisioni krahas numrit të madh të rasteve, ka arritur një kuotë të lartë të trajtimit të tyre.

1.1.2. Komisioni për Vendosje ka kapacitetet profesionale për trajtimin e kundërshtimeve dhe ka kompetencën e nevojshme lidhur me këtë. Jo në të gjitha rastet e trajtimit të kundërshtimeve, panelet shqyrtuese janë udhëhequr nga anëtari me provim të kryer të jurisprudencës. Duhet eliminuar rastet e tilla, me gjithë faktin se brenda paneleve, njëri nga anëtarët ka të kryer këtë provim. Në të gjitha rastet e trajtimit dhe shqyrtimit të kundërshtimeve, Komisioni ka vendosur brenda afateve të përcaktuara ligjore. Gjatë shqyrtimit dhe vendosjes lidhur me rastet, në disa prej tyre, Komisioni për Vendosje ka aplikuar zbutjen e sanksioneve kundërvajtëse bazuar në rrethanat lehtësuese, si një e drejtë e rikonfirmuar përmes një interpretimi të Zyrës Ligjore të Ministrisë së Drejtësisë. Në shumicën e vendimeve jepen arsyet e aplikimit të rrethanave lehtësuese, duke iu referuar situatave të përcaktuara në nenin 31 dhe 35 të Ligjit. Po ashtu, është evidentuar edhe një numër i vogël i rasteve kur vendimet nuk pasqyrojnë qartë këto situata. Është e nevojshme që në rastet e aplikimit të zbutjes së sanksionit kundërvajtës bazuar në rrethanat lehtësuese, arsyetimet të jenë më të qartësuar. Ricilësimi i kundërvajtjeve nga Organi në fjalë mbetet një fushë që kërkon një trajtim në të ardhmen dhe një definim në aspektin procedural.

1.1.3. Palëve të interesuara iu janë ofruar mundësi të ndryshme që të parashtrajnë kundërshtimet e tyre ndaj sanksioneve kundërvajtëse dhe për këtë, atyre i'u janë lëshuar vërtetime për të dëshmuar pranimin dhe dorëzimin e tyre. Lidhur me kundërshtimet dhe palët, mbahet evidencë e veçantë, e cila përmbanë të dhëna relevante. Sa i përket dokumenteve të kërkuara nga palët, dosjet janë të kompletura, ndërsa sa i përket shkresave dhe dokumenteve që nxirren nga Komisioni, shihet se në kuadër të dosjeve mungojnë procesverbalet e seancave. Vendimet e nxjerrura nga Komisioni për Vendosje përmbajnë elementet e nevojshme strukturore e formale, siç parashihet me legjisllacionin në fuqi, kurse tek përmbajtja e arsyetimit, ato duhet të jenë më të artikulueshme në aspektin logjik.

## **2. Hyrje**

---

### **2.1. Arsyet e inicimit të inspektimit**

2.1.1. Në bazë të Ligjit nr. 03/L-231, IPK-ja ka mandat ligjor që të kryejë inspektime në Polici, për të vlerësuar mënyrën e kryerjes së detyrave. Ky aktivitet ndihmon dhe mbështetë Policinë për të siguruar shërbim profesional, demokratik dhe të përgjegjshëm. Duke u bazuar në legjislacionin aktual, përveç inspektimeve që iniciohen bazuar në Planin Vjetor të Inspektimeve të Rregullta, IPK-ja zhvillon po ashtu edhe inspektime të jashtëzakonshme që mund të rrjedhin si kërkesë e Kryeshefit Ekzekutiv dhe Ministrisë të Punëve të Brendshme. Bazuar në këtë, më 1 korrik 2019, Kryeshefi Ekzekutiv i IPK-së ka kërkuar inicimin e inspektimit të jashtëzakonshëm për të vlerësuar respektimin e ligjshmërisë nga struktura policore gjatë pranimit, shqyrtimit dhe vendosjes lidhur me kundërshtimet ndaj sanksioneve kundërvajtëse. Me legjislacionin në fuqi, kundërvajtësve iu është mundësuar e drejta e kundërshtimit në Komisionin për Vendosje në kuadër të Policisë, ndaj sanksioneve kundërvajtëse të shqiptuara nga zyrtarët policor. Janë evidentuar raste kur qytetarët e gjobitur janë ndarë të pakënaqur me gjobat dhe trajtimin e kundërshtimeve nga struktura policore. Vlerësimi i kësaj fushe paraqet interes për vlerësimin e ligjshmërisë në trajtimin e rasteve.

### **2.2. Qëllimi i inspektimit**

2.2.1. Qëllimi i inspektimit është:

- Që të përcaktojë nëse ligjet, rregulloret dhe parimet e procedurat policore zbatohen si duhet dhe janë të përshtatshme për të arritur qëllimet e saja;
- Që të përcaktojë nëse burimet policore shfrytëzohen në mënyrë efektive, efikase dhe se janë të përshtatshme për të arritur qëllimet dhe objektivat;
- Që të jepet mendim objektiv mbi çështjet që lidhen me trajtimin e rasteve të kësaj natyre;
- Që të parandalojë në të ardhmen shkeljet eventuale që mund të kryhen gjatë punës policore në angazhime të kësaj natyre;
- Që të identifikojë mangësitë/dobësitë dhe të rekomandojë masa adekuate për funksionim më të mirë policor.

### **2.3. Objekti dhe subjekti i inspektimit**

2.3.1. Në këtë inspektim të jashtëzakonshëm është vlerësuar respektimi i ligjshmërisë gjatë trajtimit të kundërshtimeve të palëve të pakënaqura ndaj sanksioneve kundërvajtëse. Inspektimi është fokusuar në Komisionin për Vendosje në kuadër të Divizionit të Komunikacionit Rrugor.

### **2.4. Objektivat e inspektimit**

2.4.1. Objektivat që synon t'i arrijë ky inspektim janë:

- Vlerësimi i respektimit të rregullave dhe procedurave në trajtimin e kundërshtimeve ndaj sanksioneve kundërvajtëse;
- Vlerësimi i respektimit të të drejtave të palëve në ushtrimin e të drejtës për kundërshtim të sanksioneve kundërvajtëse; dhe
- Vlerësimi i mbajtjes së dosjeve - evidencave mbi kundërshtimet e ushtruara nga palët.

## **2.5. Rëndësia e inspektimit**

2.5.1. Inspektimi në këtë fushë të menaxhimit luan rol të rëndësishëm në:

- Ngritjen e përgjegjësisë dhe vetëdijes policore në trajtimin e duhur të kundërshtimeve;
- Identifikimin dhe parandalimin e dobësive në procedurën e trajtimit të kundërshtimeve
- Respektimin e të drejtave të palëve në cilësi të kundërvajtësve;
- Identifikimin e nevojave dhe kërkesave që shtyjnë para zhvillimin profesional policor.

## **2.6. Metodologjia e inspektimit**

2.6.1. Gjatë inspektimit:

- a) Janë zhvilluar takime-intervista me bartës funksionesh brenda Komisionit për Vendosije;
- b) Janë kryer kontrole-inspektime fizike: të të dhënave mbi palët në Sistemin Informativ të Policisë së Kosovës dhe evidencave mbi pranim - dorëzimin e kundërshtimeve të palëve;
- c) Janë siguruar dokumente, si: dosjet e 20% të lëndëve të trajtuar nga Komisioni (347 dosje janë përzgjedhur në bazë të mostrës rastësore nga një total prej 1.734 sosh), Raporti vjetor i Komisionit për Vendosije, Evidenca mbi pranim-dorëzimin e kundërshtimeve, etj.

## **2.7. Periudha e realizimit dhe mbulimit të inspektimit**

2.7.1. Bazuar në Programin e punës inspektuese, inspektimi ka filluar me datë 08.07.2019 dhe ka përfunduar me datë 19.07.2019. Inspektimi është përqendruar në vlerësimin e trajtimit të rasteve të kundërshtimeve të palëve ndaj sanksioneve kundërvajtëse, të ushtruara përgjatë vitit 2018.

## **2.8. Drejtimet e inspektimit**

2.8.1. Për përmbushjen e objektivave, inspektimi është fokusuar në këto drejtime kryesore:

- Ligjshmëria në trajtimin e kundërshtimeve të palëve ndaj sanksioneve kundërvajtëse;
- Dosjet dhe evidencat.

## **2.9. Kriteret (standardet) e vlerësimit**

2.9.1. Dokumentet në vijim janë baza, në të cilën është mbështetur puna e inspektorëve, gjatë vlerësimit të kryerjes së detyrave policore:

- Ligji nr. 05/L-088 për rregullat e trafikut rrugor;
- Ligji nr. 05/L-087 për kundërvajtje;
- Udhëzimi Administrativ nr. 15/2017 për procedurën e kundërvajtjes në trafikun rrugor;
- Procedura Standarde e Operimit për Komisionin për Vendosije (datë 29 dhjetor 2017).

## **2.10. Pengesat dhe kufizimet në arritjen e objektivave**

2.10.1. IPK-ja gjatë punës në terren fillimisht ka hasur në vështirësi në sigurimin e dosjeve të rasteve të kundërshtimeve me arsyetimin se në përmbajtjen e tyre ka edhe të dhëna personale të palëve. Kjo çështje është tejkaluar dhe IPK-së i është ofruar i tërë dokumentacioni i mostruar.

### **3. Përshkrimi i objektit, të gjeturat dhe rekomandimet**

---

#### **3.1. Ligjshmëria në trajtimin e kundërshtimeve ndaj sanksioneve kundërvajtëse<sup>1</sup>**

3.1.1. IPK ka patur në fokus trajtimin e kundërshtimeve ndaj sanksioneve kundërvajtëse në trafik, të ushtruara nga palët (kundërvajtësit) apo të autorizuarit e tyre. Legjislacioni aktual parasheh funksionimin e Organit kundërvajtës që do të trajtoj kundërshtimet ndaj sanksioneve kundërvajtëse brenda kufizimeve të përcaktuara në nenin 56 të Ligjit nr. 05/L-087 për Kundërvajtje, në kuadër të të cilit qartësohen kompetencat e këtij Organi në fjalë<sup>2</sup>. Sipas këtij Ligji, ky Organ kundërvajtës zhvillon procedurën e kundërvajtjes, nëse me ligj është paraparë kompetenca ekskluzive për veprimin e saj. Neni 60 përcakton autorizimet për zhvillimin e procedurës, sipas të cilës, në rast se pala parashtron kundërshtimin ndaj sanksionit kundërvajtës, procedura zhvillohet pranë Organit të Kundërvajtjes nga Komisioni për Vendosje.

3.1.2. Funksionin dhe kompetencën e Komisionit për Vendosje, si organ në procedurën për kundërvajtje të përcaktuar me dispozitat e Ligjit nr. 05/L-087 për Kundërvajtje, e fuqizon edhe Aktgjykimin i Gjykatës Kushtetuese nr. KO12/17, lidhur me Parashtrimin e kërkesës së Avokatit të Popullit për vlerësimin e kushtetutshmërisë me Kushtetuten të neneve 55 (paragrafët 4 dhe 5), 56, 57, 58, 59, 60, 61, 62, 63, 64, 65, 66, 67 dhe 68 të Ligjit nr. 05/L-087 për Kundërvajtje. Me këtë Aktgjykim, Gjykata konstaton se nenet e ligjit të cekura me lartë janë në përputhje me nenin 31 (E drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm) të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (E drejta për një proces të rregullt).

3.1.3. Komisioni për Vendosje është themeluar nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës, më 07.12.2017, afërsisht një (1) vit pas hyrjes në fuqi të Ligjit nr. 05/L-087 për Kundërvajtjet. Bazuar në Procedurën Standarde të Operimit për Komisionin për Vendosje (datë 29.12.2017), ky Komision ka funksionuar fillimisht në kuadër të Drejtorisë për Planifikim Strategjik dhe Çështje Ligjore. Me reformën e re organizative të datës 28.02.2019, Komisioni për Vendosje funksionon në kuadër të Divizionit të Komunikacionit Rrugor, si një trup i veçantë. Sistemimi i Komisionit për Vendosje si organ brenda strukturës së Divizionit të Komunikacionit Rrugor, si organ i shkallës së dytë, brenda të njëjtës strukturë me njësitë policore të trafikut rrugor (organin e shkallës së parë), të cilët bëjnë shqiptimin e sanksioneve për kundërvajtjet në trafik, konsiderohet së mund të shfaqë rrezik evident për cenimin e pavarësisë së këtij Organi gjatë vendosjes lidhur me kundërshtimet e palëve ndaj sanksioneve kundërvajtëse në trafik. IPK-ja vlerëson së është thelbësore të shqyrtohet mundësia e rishikimit të sistemimit të këtij Organi brenda strukturës policore, me qëllim të ngritjes së pavarësisë dhe besueshmërisë së organit.

---

<sup>1</sup> Sipas nenit 2 të Ligjit për Kundërvajtje, nocioni kundërvajtje është sjellja me të cilën shkelet ose rrezikohet rendi dhe qetësia publike dhe vlerat shoqërore të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, mbrojtja e të cilave nuk është e mundur pa sanksionimin kundërvajtës.

<sup>2</sup> Sipas nenit 56 të Ligjit për Kundërvajtje, organi kundërvajtës zhvillon procedurën e kundërvajtjes, nëse me ligj është paraparë kompetenca ekskluzive për veprimin e saj. Sipas këtij neni, organi për kundërvajtje është kompetent që të veprojë sipas të gjitha kundërvajtjeve: (a) për të cilat është paraparë sanksioni i gjobës në shumën e caktuar; (b) për të cilat është paraparë sanksioni për personin fizik gjoba deri në pesëqind (500) € (c) për të cilat është paraparë sanksioni për personin juridik gjoba deri në njëmijë (1.000) € dhe (d) për të cilat është paraparë shqiptimi i gjobës në vend.



3.1.4. Komisioni për Vendosje ka në dispozicion një mori aktesh ligjore dhe nënligjore, në të cilat mbështetë punën në cilësi të Organit kundërvajtës. Dokument bazik është Ligji nr. 05/L-087 për Kundërvajtjet, i cili parasheh ekskluzivitetin e këtij Organi për trajtimin e të gjitha kundërvajtjeve në kufijt siç parashihet në nenin 56 të Ligjit. Ministria e Punëve të Brendshme ka nxjerrë një akt nënligjor<sup>3</sup> që rregullon procedurën e kundërvajtjes në trafik, brenda të cilit pasqyrohen aspekte të punës së Komisionit për Vendosje. IPK vlerëson se nevojitet nxjerrja e një dokumenti, që qartëson kompetencat në detaje të Komisionit për Vendosje brenda procedurës së shqyrtimit dhe vendosjes. Dokumenti i tillë do të qartësonte edhe fushat, si: rikualifikimi i shkeljeve, llojet e vendimmarrjes, transferimi i përgjegjësi për shkelje tek pjesëmarrësit tjerë të trafikut, funksionimin e Komisionit si trupë e përhershme dhe me pjesëmarrje panelesh, etj.

3.1.5. Nga numri i përgjithshëm prej 1.791 kundërshtimeve të pranuar, Komisioni për Vendosje është mbledhur në 191 seanca dhe ka shqyrtuar 97% të kundërshtimeve. Mesatarisht ky Komision është mbledhur çdo të dytën ditë dhe gjatë çdo seancë ka shqyrtuar rreth nëntë (9) raste apo lëndë. Vlerësohet se Komisioni ka pasur ngarkesë evidente në trajtimin e rasteve dhe çmohet puna e bërë në trajtimin e kundërshtimeve. DRP-Prishtinë dhe Prizren kanë shënuar numrin më të madh të këtyre kundërshtimeve duke u dalluar si rajone, ndaj të cilave janë ushtruar më së shumti kundërshtime (35% përkatësisht 21% të numrit të përgjithshëm të kundërshtimeve në nivel vendi). Numër më të vogël të kundërshtimeve ka shënuar DRP- Mitrovicë Veriu me pjesëmarrje prej 0.7% të numrit të përgjithshëm të kundërshtimeve në nivel vendi. Komisioni për Vendosje në 9.6% të rasteve i ka shpallur kundërshtimet si të bazuara, në 69.5% si të pabazuara, në 16.9% si pjesërisht të bazuara, në 2.3% i ka konsideruar si të pasafatshme, në 1.6% të rasteve e ka konsideruar veten jokompetente për të trajtuar rastet e parashtruara.

3.1.6. IPK është interesuar të njihet lidhur me respektimin e dispozitave ligjore mbi kompetencën e Komisionit për trajtimin e kundërshtimeve ndaj sanksioneve kundërvajtëse. Neni 56 i Ligjit për Kundërvajtje, përcakton se Organi kundërvajtës zhvillon procedurën e kundërvajtjes, nëse me ligj është paraparë kompetenca ekskluzive për veprimin e saj. Organi për kundërvajtje është kompetent që të veprojë sipas të gjitha kundërvajtjeve: (a) për të cilat është paraparë sanksioni i gjobës në shumën e caktuar; (b) për të cilat është paraparë sanksioni për personin fizik gjoba deri në pesëqind (500) € (c) për të cilat është paraparë sanksioni për personin juridik gjoba deri në njëmijë (1.000) € dhe (d) për të cilat është paraparë shqiptimi i gjobës në vend. IPK-ja ka siguruar një mostër të gjërë prej 20% të totalit të përgjithshëm të rasteve dhe gjatë analizimit të 347 dosjeve nuk ka hasur në kundërshtime që janë trajtuar nga Komisioni dhe për të cilat nuk ka qenë kompetent. Komisioni ka pranuar edhe një numër kundërshtimesh, për të cilat nuk ka qenë kompetent t'i shqyrtojë, por që i ka adresuar te organet tjera, duke e shpallë veten jokompetent për trajtimin e tyre. IPK vlerëson pozitivisht përkushtimin e Komisionit dhe e inkurajon atë për vazhdimin e praktikës së trajtimit të rasteve brenda kompetencës lëndore.

3.1.7. Trajtimi i kundërshtimeve ndaj sanksioneve kundërvajtëse parasheh edhe kufizimet kohore që duhet të merren parasysh nga Komisioni për Vendosje. Bazuar në autorizimet për zhvillimin e procedurës, parashihet që në rast se pala parashtron kundërshtimin ndaj sanksionit kundërvajtës, procedura zhvillohet pranë Organit të kundërvajtjes nga Komisioni për Vendosje. Bazuar në ligjin në fuqi, parashtrimi i kundërshtimit duhet të bëhet brenda tetë (8) ditësh. Ministria e Punëve të

<sup>3</sup> Ministria e Punëve të Brendshme, *Udhëzimi Administrativ nr. 15/2017 për procedurën e kundërvajtjes në trafikun rrugor*, datë 26.12.2017, Prishtinë.



Brendshme këtë fushë e ka qartësuar edhe me një akt nënligjor<sup>4</sup> mbi procedurat e kundërshtimit, sipas të cilit, kundërvajtësi mund të parashtrijë kundërshtim me shkrim në afatin prej tetë (8) ditësh nga data kur është shqiptuar gjoba. Komisioni për Vendosje ka pranuar një mori kundërshtimesh ndaj sanksioneve kundërvajtëse të ushtruara jashtë afatit të paraparë dhe dyzetë (40) prej tyre gjatë vitit 2018 i ka konsideruar të pasafatshme. Është identifikuar një (1) rast<sup>5</sup> ku Komisioni ka trajtuar kundërshtimin e pasafatshëm, të rezultuar me vendim si "i pabazuar". Kjo situatë është krijuar si rrjedhojë e ngarkesës në punë të Komisionit. IPK-ja vlerëson se Komisioni për Vendosje në të ardhmen duhet të jetë më i kujdesshëm në evitimin e këtyre situatave, në drejtim të aplikimit të drejtë të rregullave të procedurës lidhur me afatet ligjore.

3.1.8. Neni 60 që rregullon autorizimet për zhvillimin e procedurës, përcakton përbërjen e organit kundërvajtës prej së paku tre (3) anëtarëve. Sipas Ligjit, anëtarët e Komisionit për Vendosje duhet të jenë personat zyrtar të autorizuar me shkallën përkatëse të përgatitjes profesionale dhe përvojës së punës së nevojshme, nga të cilët, së paku një duhet të jetë jurist i diplomuar me provim të dhënë të jurisprudencës. Ky Komision është themeluar me vendim të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë, ka filluar të punojë si një komision funksional jashtë strukturor. Me reformën e re organizative, ky Komision është i organizuar si trup i veçantë strukturor në kuadër të Divizionit të Komunikacionit Rrugor dhe personeli i tij është sistemuar me vendime të Drejtorisë së Personelit të Departamentit të Burimeve Njerëzore. Kryesuesi i Komisionit është jurist i diplomuar dhe ka të kryer provimin e jurisprudencës dhe IPK ka siguruar dëshmi lidhur me këtë. Veç tij, edhe një (1) anëtar i përhershëm i Komisionit është i pajisur me çertifikatë të tillë. Anëtarët e përhershëm të Komisionit janë njohës të fushës juridike, trafikut dhe të sigurisë. Procedura Standarde e Operimit për Komisionin për Vendosje cekë që anëtari i Komisionit të Vendosjes që është jurist dhe me provim jurisprudence, është njëkohësisht edhe Kryesuesi i Komisionit. Është e paqartë se kjo a i referohet vetë Komisionit apo paneleve që nuk potencohen në procedurë. IPK-ja ka hasur në 20 raste<sup>6</sup> të ekzaminuara gjatë inspektimit, kur Kryesuesi që ka udhëhequr me procedurë gjatë trajtimit dhe shqyrtimit të rasteve, nuk dëshmohej se ka të kryer provimin e jurisprudencës. IPK-ja vlerëson se dokumenti që është i nevojshëm të nxjerret siç u potencua në paragrafin 3.1.4 të këtij Raporti, duhet të qartësojë këto mangësi, në mënyrë që të specifikohen më mirë detajet lidhur me procedurën dhe statusin e zyrtarëve dhe Komisionit.

#### ***Rekomandimi nr. 1***

*IPK-ja i rekomandon Kryesuesit të Komisionit për Vendosje që në drejtim të përmbushjes së obligimeve që dalin nga Procedura Standarde e Operimit për Komisionin për Vendosje, të kujdesen që anëtari i Komisionit si jurist dhe me provim të jurisprudencës, të udhëheqë me përbërjen e Komisionit apo panelit gjatë procedurës së shqyrtimit të kundërshtimeve të ngritura.*

3.1.9. IPK-ja ka kontrolluar lëndët e përzgjedhura në baza rastësore nëse Komisioni për Vendosje ka marrë vendime brenda afateve të parapara ligjore. Neni 62 i Ligjit në paragrafin 6 përcakton se Organi i kundërvajtjes (Komisioni për Vendosje) është i obliguar që në afatin prej tridhjetë (30)

<sup>4</sup> Ministria e Punëve të Brendshme, *Udhëzimi Administrativ (MPB) nr. 15/2017 për procedurën e kundërvajtjes në trafikun rrugor*, neni 12.

<sup>5</sup> Lënda e Komisionit për Vendosje me numër 55/2018.

<sup>6</sup> Lëndët: 1579/2018, 1684/2018, 1657/2018, 1714/2018, 1724/2018, 1568/2018, 1569/2018, 1584/2018, 1616/2018, 1635/2018, 1638/2018, 1665/2018, 1668/2018, 1672/2018, 1674/2018, 1680/2018, 1690/2018, 1695/2018, 1729/2018 dhe 1673/2018.

ditësh, me shkrim t'a informojë paraqitësin e kërkesës për vendimin, që mos të nxirret vendimi për kundërvajtje, përkatësisht të mos paraqitet kërkesa për zhvillimin e procedurës së kundërvajtjes në gjykatën kompetente, si dhe për arsyet e vendimit. IPK-ja nuk ka hasur që në ndonjë situatë që Komisioni të mos ketë nxjerr vendim lidhur me rastet e shqyrtuara, d.m.th se Komisioni ka trajtuar lëndët brenda afateve të përcaktuara ligjore. Nga dosjet e kontrolluara është vërejtur se periudha pas vendosjes është menaxhuar mirë dhe nuk është rrezikuar apo shkurtuar periudha tjetër për të ushtruar padi eventuale për të ngritur konflikt administrative në gjykatën kompetente. Palët janë pajisur me vendime dhe kanë nënshkruar pranimin e tyre, të cilat kanë përmbajtur edhe arsyet e nxjerrjes së tyre.

3.1.10. Procedura në fuqi për trajtimin e kundërshtimeve të palëve ndaj sanksioneve kundërvajtëse ka paraparë edhe shtyrjen e afateve kohore të vendimmarrjes në raste të kompleksitetit të lëndëve. Në rastet e tilla parashihet që pala të njoftohet me vendimin procedural të shtyrjes brenda afatit fillestar. IPK-ja është interesuar të njihet me situatat që mund të jenë përcjellur me shtyrje afatesh të vendimmarrjes dhe lidhur me këtë vlerëson se të gjitha lëndët e trajtuara nuk janë përcjellur me këto situata. Kjo nënkupton se Komisionit për Vendosje nuk i është nevojitur të shtyjë afatet e vendimmarrjes, pasi që të gjitha lëndët janë trajtuar brenda afateve ligjore fillestare dhe nuk kemi patur ndonjë lëndë komplekse. Për të gjitha lëndët e kundërshtimeve janë marrë vendime brenda tridhjetë (30) ditëve nga pranimi i kundërshtimit. Kjo vlerësohet pozitivisht dhe vie në shprehje ekspeditiviteti dhe efikasiteti i Komisionit në trajtimin serioz të lëndëve (kundërshtimeve).

3.1.11. Komisioni për Vendosje gjatë trajtimit dhe shqyrtimit të kundërshtimeve ndaj sanksioneve kundërvajtëse ka marrë parasysh rrethanat lehtësuese në disa prej rasteve të inspektuara. Neni 31 mbi rregullat e përgjithshme për matjen e sanksionit kundërvajtës, përcakton se “Gjykata do t’ia caktoj lartësinë e sanksionit kundërvajtës, kryesit duke marr parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese, në veçanti peshën e kundërvajtjes dhe pasojat, shkallën e përgjegjësisë, motivet nga të cilat dhe rrethanat nën të cilat është kryer kundërvajtja, jeta e mëhershme e kryesit, gjendja e tij personale dhe qëndrimi i tij pas kundërvajtjes së kryer, gjendja e tij pasurore, si dhe rrethanat e tjera që kanë të bëjnë me personalitetin e kryesit. Bazuar në Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese nuk vie në diskutim se a ka të drejtë Organi kundërvajtës të aplikojë rrethanat lehtësuese me rastin e vendosjes lidhur me rastet e shqyrtuara.

3.1.12. IPK-ja gjatë inspektimit të dosjeve ka patur për fokus edhe fushën e zbutjes së sanksionit kundërvajtës. Ligji aktual nuk ofron qartësinë e duhur kur i referohet kufirit minimal për dhënien e sanksionit kundërvajtës. Neni 35 lidhur me zbutjen e sanksionit kundërvajtës përcakton se “Nëse me rastin e caktimit të sanksionit kundërvajtës konstatohet se me kundërvajtje nuk janë shkaktuar pasoja të rënda, ndërsa ekzistojnë rrethanat lehtësuese që vëjnë në dukje se edhe me një sanksion kundërvajtës më të butë mund të arrihet qëllimi i sanksionit kundërvajtës, sanksioni kundërvajtës i dhënë mund të zbutet në njërin prej kësaj mënyrave: (1.1) të jepet sanksioni kundërvajtës nën masën minimale të dënimit që është përcaktuar për atë kundërvajtje, por jo nën masën minimale ligjore të atij lloji të sanksionit kundërvajtës”. Lidhur me kufirin minimal të zbutjes së sanksionit, Kryesuesi i Komisionit më 13 shkurt 2018 i ka kërkuar interpretim Zyrës Ligjore të Ministrisë së Drejtësisë, nga e cila edhe ka marrë një të tillë, ku i janë qartësuar kufijt minimal të zbutjes së dënimit. Kjo fushë nuk është objekt për vlerësim, por mbetet temë për trajtim, pjesa e arsyetimit në situata kur në rastet e trajtuara me sanksione kundërvajtëse, Komisioni ka marrë parasysh

rrethanat lehtësuese mbi bazën e të cilave edhe ka zbutur sanksionet. IPK-ja ka identifikuar lëndë<sup>7</sup> kur janë aplikuar zbutjet e sanksioneve për shkak të rrethanave lehtësuese, por lidhur me të cilat nuk janë dhënë arsyet e nevojshme për të arsyetuar zbatimin e dispozitës së caktuar. IPK-ja vlerëson se është e nevojshme që marrja parasysh e rrethanave të tilla duhet arsyetuar, për t'u mos u keqinterpretuar. Në situatat kur Komisioni aplikon dispozitë për zbutje sanksioni, i njëjti duhet të bëjë të qarta në mënyrë objektive këto rrethana, që kanë ndikuar në zbutjen e sanksioneve.

### **Rekomandimi nr. 2**

*IPK-ja i rekomandon Kryesuesit të Komisionit për Vendosje që në situata kur trajtohen raste në të cilat aplikohet dispozitat ligjore për zbutjen e sanksionit kundërvajtës, të sigurohet se jepen arsyet e mjaftueshme dhe të bazuara për shkaqet që shpiejnë në aplikimin e rrethanave lehtësuese.*

3.1.13. Gjatë kontrollimit të dosjeve, IPK-ja ka vërejtur se Komisioni për Vendosje në disa prej rasteve të trajtuara ka bërë ricilësimin e kundërvajtjes. Lidhur me këtë, IPK nuk ka gjetur një bazë ligjore, mbi të cilën është vendosur të bëhet rikualifikimi i shkeljes (kundërvajtjes). Vlerësohet se Komisioni për Vendosje duhet të përfshijë këtë fushë si pjesë të një dokumenti, ku veç mangësisve tjera, të rregullojë edhe këtë çështje. Një gjë e tillë nuk parashihet apo precizohet as në kapitullin VI (Procedura e punës së Komisionit) të Procedurës Standarde të Operimit për Komisionin për Vendosje. Bazuar në praktikat gjyqësore, ricilësimi i veprave bëhet nga organi ndjekës dhe një gjë e tillë parashihet me procedurë.

## **3.2. Dosjet dhe evidencat**

3.2.1. Gjatë kontrollimit të dosjeve të kundërshtimeve dhe regjistrave, IPK-ja ka patur në fokus mbajtjen e evidencave nga ana e Komisionit mbi kundërshtimet e pranuar, plotësimin e formularit për dorëzim të kundërshtimit dhe mbajtjen e dosjeve të rasteve me dokumentacionin e nevojshëm për trajtim, shqyrtim dhe vendosje. Udhëzimi Administrativ (MPB) nr. 15/2017 rregullon mënyrën e parashtrimit të kundërshtimit në rast kur pala ndahet e pakënaqur me shqiptimin e sanksionit kundërvajtës. Sipas nenit 12 të Udhëzimit, kundërshtimi parashtrohet në cilëndo Njësi Rajonale të Trafikut Rrugor ose Njësinë për Kontroll të Autostradës, pavarësisht vendbanimit të kundërvajtësit apo vendit ku i është shqiptuar fletëparaqitja. IPK-ja vlerëson se palëve iu është ofruar mundësi e mirë që të parashtrorjnë kundërshtimet dhe varësisht nga njësitë që kanë pranuar kundërshtimet, nuk është vërejtur se janë shkaktuar vonesa në procedimin e tyre tek Komisioni për Vendosje.

3.2.2. Udhëzimi në fjalë ka përcaktuar se kundërvajtësi me rastin e dorëzimit të kundërshtimit duhet të bashkëngjisë edhe fletëparaqitjen e marrë nga Policia. Udhëzimi sqaron se kundërshtimi duhet të përmbajë të dhënat themelore të parashtruesit të kundërshtimit, kopjen e letërnjoftimit, kopjen e patentë shoferit, adresën e vendbanimit, numrin e telefonit apo adresën elektronike nëse ka. Gjatë verifikimit të dosjeve të kundërshtimeve, IPK-ja ka vërejtur se ato janë të plota dhe përmbajnë informatat e kërkuar. Udhëzimi përcakton se parashtruesit të kundërshtimit, zyrtari përgjegjës i jep dëshmi (vërtetim) për pranimin e kundërshtimit dhe i njëjti evidentohet në bazën e të dhënave. IPK-ja ka vërejtur se formulari është i standardizuar dhe është përdorur në të gjitha rastet e pranimit-dorëzimit të kundërshtimeve. Formulari përmbanë informatat e nevojshme dhe

<sup>7</sup> Lëndët e Komisionit për Vendosje nr: 135/2018 dhe 262/2019.

shërben për verifikim të dorëzimit të kundërshtimit, afateve të dorëzimit, si dhe personave që dorëzojnë kundërshtimet. Vërtetimi për pranimin e kundërshtimit si një formular i standardizuar është nënshkruar nga palët, ajo pranuese (Policia) dhe pala dorëzuese (pala).

3.2.3. Komisioni për Vendosje përmes Sekretarisë së tij mbanë një Evidencë elektronike mbi të gjitha kundërshtimet e palëve ndaj sanksioneve kundërvajtëse. IPK-ja ka verifikuar informacionet që i përmban kjo bazë e të dhënave dhe ka vërejtur se brenda saj janë të inkuorporuara një numër i konsideruar të dhënash, përfshirë të dhënat personale të palës, afatet brenda procedurës së trajtimit të kundërshtimeve dhe të dhënat mbi rezultatit e vendimmarrjes. IPK vlerëson se baza e të dhënave përmban informacionin e nevojshëm dhe gjatë demonstrimit të funksionimit të tij, informatat janë lehtësisht të qasshme.

3.2.4. Procedura Standarde e Operimit për Komisionin për Vendosje përcakton në kapitullin VI lidhur me procedurën e punës, se gjatë shqyrtimit të kundërshtimit mbahet procesverbal. Më tutje, kjo Procedurë përcakton se procesverbali përmban rezultatet e votimit të anëtarëve, nënshkruhet nga personi që e mbanë atë dhe të gjithë anëtarët që kanë marrë pjesë në shqyrtim dhe vendim. Rregullat e mbajtjes së procesverbalit për organet kolegjiale janë të përcaktuara edhe me nenin 43 (Procesverbali i mbledhjeve) të Ligjit nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative. IPK-ja ka kontrolluar dosjet që ka zgjedhur në baza rastësore dhe në asnjërën prej tyre nuk ka hasur në procesverbale të mbajtura nga Komisioni. IPK është interesuar të kuptoj arsyet e mosmbajtjes së procesverbalit dhe nga intervistat me zyrtarë të Komisionit ka kuptuar se gjatë shqyrtimit të lëndëve, Komisioni mbanë regjistrime audio përmes diktafonit, por që nuk janë të transkriptuara. Sipas tyre, mbajtja e procesverbalit merr kohë dhe njëkohësisht ndikon në punën e Komisionit për shkak të numrit të madh të lëndëve. Në mungesë të procesverbalit të seancës, nuk ka mundësi të jepjen nënshkrimet e procesmbajtësit dhe anëtarëve të Komisionit, siç përcaktohet me Procedurë. Në mungesë të procesverbaleve dhe bashkëngjitjes së tyre në lëndë (dosje), mund të cenohet rregullësia e procedurës administrative të përcaktuar me ligjin bazik dhe Procedurën Standarde të Operimit, andaj vlerësohet se Komisioni duhet t'i përmbahet rregullave të përcaktuara ngase ato e obligojnë atë për të mbajtur një evidencë të tillë.

### **Rekomandimi nr. 3**

*IPK-ja i rekomandon Kryesuesit të Komisionit për Vendosje që të rishikojë politikën aktuale lidhur me procesverbalin e seancës dhe në të ardhmen të respektojë rregullat dhe procedurën që dalin nga Ligji për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe Procedurën Standarde të Operimit të Komisionit për Vendosje, me qëllim të pasqyrimin dhe evidentimit të procesit të trajtimit, shqyrtimit dhe vendosjes së rasteve.*

3.2.5. Neni 58 i Ligjit për Kundërvajtje përcakton se “Për kundërvajtje dhe për shqiptimin e sanksionit të kundërvajtjes vendos gjykata, përkatësisht organi i kundërvajtjes me vendim, kundër të cilave lejohen mjetet juridike të përcaktuara me këtë ligj”. Veç tjerash edhe neni 62 lidhur me Vendimin sipas kërkesës për zhvillimin e procedurës së kundërvajtje, në paragrafin 2 përcakton se “Nëse organi i kundërvajtjes vërteton se ekzistojnë kushtet ligjore për zbatimin e procedurës së kundërvajtjes, është i detyruar që t’a zbatojë dhe të nxjerrë vendim për kundërvajtje”. Shikuar nga ky rrafsh, fokus i inspektimit ka qenë vërtetimi i respektimit të dispozitave ligjore mbi nxjerrjen e vendimeve nga Komisioni për Vendosje. IPK ka inspektuar 347 dosje të shqyrtuara nga Komisioni

dhe vlerëson se në të gjitha rastet, ka nxjerrë vendime që pasqyrojnë rezultatin e kundërshtimeve të ushtruara nga palët. Të gjitha vendimet e kontrolluara, në aspektin formal strukturor janë të plota dhe përmbajnë: pjesën e hyrjes, dispozitivin, arsyetimin dhe këshillën juridike. Në aspektin formal strukturor, vendimet përmbushin standardet e kërkuara. Nëse analizohet ana logjike e përmbajtjes së vendimeve, tek pjesa e arsyetimit janë evidetuar disa paqartësi në artikullimin e tekstit dhe kjo përcillet tek një numër i konsideruar vendimesh lidhur me kuptimin logjik të paragrafëve në pjesët e fundit të arsyetimit. Janë vlerësuar paqartësi në kuptimin logjik që mund të krijojnë paqartësi për lexuesit apo palët. Krahas angazhimeve dhe përkushtimit të vazhdueshëm në punë, në të ardhmen Komisioni duhet të angazhohet në eliminimin e paqartësive evidente, gjithnjë në drejtim të ngritjes së profesionalizmit dhe performancës së Organit.

## 4. Plani i përmbushjes së rekomandimeve

### 4.1. Plani për përmbushjen e rekomandimeve

4.1.1. Mbi bazën e gjetjeve, IPK-ja ka dhënë një numër rekomandimesh dhe pas komenteve të ofruara nga menaxhmenti policor në takimin përmbyllës të datës 18.09.2019, është vendosur që ato të realizohen sipas Planit të veprimit të prezantuar në tabelën e mëposhtme.



Nr.	Rekomandimi	Niveli i prioritetit	Komentet e strukturës policore	Plani i veprimit
1.	<i>IPK-ja i rekomandon Kryesuesit të Komisionit për Vendosje që në drejtim të përmbushjes së obligimeve që dalin nga Procedura Standarde e Operimit për Komisionin për Vendosje, të kujdesen që anëtari i Komisionit si jurist dhe me provim të jurisprudencës, të udhëheqë me përbërjen e Komisionit apo panelit gjatë procedurës së shqyrtimit të kundërshtimeve të ngritura.</i>	<i>-I-</i>	<i>Është kërkesë e parapare në nenin 60 paragrafi 2 i Ligjit 05/L-087 për Kundërvajtje që në secilin panel për trajtimin e kundërshtimeve së paku një nga anëtarët të jetë jurist i diplomuar me provim të dhënë të jurisprudencës. Që nga themelimi i Komisionit për Vendosje kjo kërkesë e ligjit është përfillur me përpikëri. Duke qene një rekomandim që do të ngrit edhe me tutje performancën, do të ishte shumë e dëshiruar që ky rekomandim të implementohej sa më parë. Në Komisionin për Vendosje është i emëruar vetëm një anëtar me provim të dhënë të jurisprudencës plus kryesuesi i Komisionit që përveç pjesëmarrjes në panele ka edhe shume detyra menagjeriale. Komisioni për Vendosje ka parashtruar një kërkesë për shtim të numrit të anëtarëve të Komisionit për Vendosje edhe për dy anëtar dhe pretendohet që të dy këta anëtar të kenë të dhënë provimin e jurisprudencës. Pritjet tona janë që para përfundimit të këtij viti kalendarik të përfundojnë procedurat e emërimit të këtyre dy anëtarëve e që nënkupton se me fillimin e vitit 2020 do të jemi në gjendje që në plotni të</i>	<i>Fillimi i vitit 2020</i>



			<i>implementohet rekomandimi. E gjithë kjo varet prej ndryshimeve që do të ndodhin në Strukturën Organizative të Komisionit për Vendosje.</i>	
2.	<i>IPK-ja i rekomandon Kryesuesit të Komisionit për Vendosje që në situata kur trajtohen raste në të cilat aplikohet dispozitat ligjore për zbutjen e sanksionit kundërvajtës, të sigurohet se jepen arsyet e mjaftueshme dhe të bazuara për shkaqet që shpiejnë në aplikimin e rrethanave lehtësuese.</i>	<i>-I-</i>	<i>Fillimi i vitit 2018 ka qene edhe fillimi i punës se Komisionit për Vendosje. Marrja e kompetencave gjyqësore pa një përgatitje te posaçme te stafit por edhe pa staf permanent te punësuar ne Komisionin për Vendosje ka bere qe edhe vendimet ne tërësi por edhe arsyetimi si pjese e vendimit te jene ne nivel te kënaqshëm por jo te dëshiruarin. Me kalimin e kohës edhe vendimet ne tersi por edhe arsyetimi ne veçanti është përmirësuar vazhdimisht, duke bere qe vendimet e Komisionit për Vendosje te vlerësohen lart edhe nga vete gjykatat. Se janë nxjerr vendime te mira dhe mire te arsyetuara tregon edhe fakti se ne me shume se 3400 vendime te nxjerra deri me tani asnjë vendim nuk është prishur nga gjykatat. Dihet mirëfilli qe çdo dështim ne arsyetim te një vendimi paraqet baze te mjaftueshme për prishje apo ndryshim te vendimit nga shkalla me e larte ne këtë rast gjykata, gjë e cila nuk ka ndodh. Komisioni për Vendosje e merr si qellim mire rekomandimin dhe është i përkushtuar qe ne vazhdimësi te përmirësoj vendimet e veta e këtu gjithsesi edhe arsyetimin e vendimeve qe nxirren nga Panelet e komisionit për Vendosje. Ky rekomandim do te implementohet ne vazhdimësi.</i>	<i>Në vazhdimësi</i>
3.	<i>IPK-ja i rekomandon Kryesuesit të Komisionit për Vendosje që të rishikojë</i>	<i>-I-</i>	<i>Fillimi i punës se Komisionit për Vendosje ne fillim te vitit 2018, pa asnjë te punësuar ne komision, me</i>	



<p><i>politikën aktuale lidhur me procesverbalin e seancës dhe në të ardhmen të respektojë rregullat dhe procedurën që dalin nga Ligji për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe Procedurën Standarde të Operimit të Komisionit për Vendosje, me qëllim të pasqyrimin dhe evidentimit të procesit të trajtimit, shqyrtimit dhe vendosjes së rasteve.</i></p>	<p><i>kryesues që komisionin e kishte punë të dyte, pa anëtar të rregullt të Komisionit për Vendosje, pa staf mbështetës, numri i madh i kundërshtimeve të pranuar në Komision (kalimi i lendeve që ishin kompetencë e 38 departamenteve për kundërvajtje të gjykatave respektive), kishte determinuar që procesverbali të mbahej vetëm me incizim në audio të të gjitha seancave vendimmarrëse të paneleve të Komisionit për Vendosje. Për implementimin e këtij rekomandimi do të jete i nevojshëm se paku edhe një zyrtar nga stafi civil e që nga Komisioni për Vendosje do të behet kërkesë zyrtare për rekrutimin të një zyrtari. Në Komisionin për Vendosje për shkak të volumit të lendeve dhe për shkak se lendet janë të ndara në kundërvajtje dhe në aksidente të trafikut, mbahen seanca nga dy panele në të njëjtën kohë, e që nënkupton që secili panel duhet të ketë edhe një procesmbajtës.</i></p>	
---	---	--



<b>Shtojcë - Mostrat e përzgjedhura në mënyrë rastësore sipas kategorive të vendimmarrjes lidhur kundërshtimet ndaj sanksioneve kundërvajtëse (14 maj 2019)</b>			
<b>Kategoria e vendimeve</b>	<b>Kundërshtime të shqyrtuara</b>	<b>Numri i dosjeve sipas mostrës (20%)</b>	<b>Dosjet e përzgjedhura sipas rastësisë</b>
Të bazuara	166	33	61, 44, 92, 39, 1, 22, 54, 91, 140, 129, 106, 162, 142, 119, 31, 87, 124, 111, 134, 161, 37, 60, 59, 24, 77, 12, 164, 107, 155, 136, 66, 102, 104
Të pabazuara	1.206	241	504, 496, 916, 278, 154, 412, 728, 10, 989, 1178, 248, 763, 1111, 510, 371, 857, 639, 621, 842, 255, 498, 1055, 768, 638, 873, 847, 644, 619, 425, 997, 66, 215, 876, 253, 426, 1140, 1075, 852, 891, 80, 521, 211, 841, 380, 844, 404, 719, 88, 791, 559, 373, 770, 895, 1182, 347, 753, 615, 813, 1168, 242, 888, 660, 554, 925, 341, 297, 1169, 124, 517, 286, 798, 384, 457, 508, 512, 234, 502, 845, 1002, 626, 70, 328, 799, 707, 1167, 398, 130, 51, 472, 456, 265, 1149, 696, 453, 877, 740, 48, 460, 1018, 662, 1028, 1098, 111, 839, 198, 369, 206, 815, 381, 974, 1164, 1172, 726, 701, 980, 787, 141, 905, 237, 778, 480, 610, 505, 223, 17, 649, 924, 893, 355, 260, 1165, 392, 607, 555, 229, 628, 944, 1091, 1201, 491, 1030, 884, 889, 25, 79, 1116, 1076, 840, 16, 731, 566, 423, 1051, 1090, 1128, 1022, 1077, 864, 123, 157, 609, 30, 1138, 822, 176, 543, 509, 104, 107, 448, 1049, 191, 201, 599, 164, 826, 801, 94, 183, 119, 945, 797, 817, 987, 315, 329, 1000, 45, 422, 871, 24, 1037, 106, 995, 680, 359, 49, 914, 1083, 38, 536, 875, 1078, 121, 1190, 316, 105, 771, 15, 277, 1023, 447, 560, 317, 96, 978, 832, 608, 331, 929, 933, 383, 1142, 350, 1044, 368, 849, 773, 779, 1035, 216, 981, 507, 646, 35, 739, 127, 982, 246, 794, 575
Pjesërisht të bazuara	294	59	32, 185, 165, 289, 24, 27, 137, 125, 294, 273, 163, 154, 293, 174, 60, 16, 5, 147, 181, 128, 209, 287, 169, 257, 236, 84, 158, 124, 160, 52, 123, 29, 208, 54, 244, 229, 120, 91, 199, 193, 250, 190, 223, 221, 56, 170, 282, 7, 183, 246, 150, 112, 233, 276, 151, 260, 96, 68, 119
Të pasafatshme	40	8	39, 21, 13, 35, 8, 19, 28, 11
Jokompetente	28	6	3, 7, 1, 6, 21, 26
<b>Gjithsej dosje të shqyrtuara<sup>8</sup></b>	<b>1.734</b>	<b>347</b>	

<sup>8</sup> Shifra prej 1.734 është nxjerrë nga Raporti Vjetor i Komisionit për Vendosje (2018) dhe paraqet vetëm numrin e përgjithshëm të rasteve të shqyrtuara gjatë vitit 2018.